



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

VENDIM

Nr 25, datë 27/07/2016

PËR SISTEMIMIN E FËMIJËS K. K NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLOR 6-18 VJEÇ, SARANDË

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 27.07.2016, në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015, datë 17/12/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr.10 347 datë 04/11/2010 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Femijës”, Udhëzimit Nr. 6, datë 21.05.2014 “Për procedurat e sistemimit të fëmijëve në institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror, publike dhe jopublike”, kërkesës me nr.2028 prot, datë 30.06.2016 të Bashkisë Himarë si dhe referimit të bërë nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve, Bashkia Himarë.

VENDOSI;

1. Fëmija K. K të sistemohet menjëherë në institucionin e Shtëpisë së Fëmijëve Shkollor 6-18 vjeç, Sarandë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli i Qarkut Vlorë, Bashkia Himarë dhe Bashkia Sarandë.

REPUBLICA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË
SADRI DANAJ
KRYETARI